



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 145

**Tiranë – E premte, 14 korrik 2017**

## PËRMBAJTJA

	Faqe	
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 485, datë 13.7.2017	Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Zhvillimit Urban tek Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, sh.a., të një pjese të pronës me numër pasurie 1/63, ndodhur në zonën kadastrale nr. 8150, rruga “Abdi Toptani”, Tiranë.....	6959
Udhëzim i ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 3743, datë 10.7.2017	Mbi modelet dhe standardet e biletave të transportit rrugor të udhëtarëve.....	6963
Urdhër i ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nr. 156, datë 14.7.2017	Për delegimin e kompetencave.....	6970
Vendim i Entit Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 19, datë 11.5.2017	Për licencimin e sh.a. Ujësjetllës Kanalizime Librazhd.....	6970
Vendim i Entit Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 22, datë 7.6.2017	Për licencimin e sh.a. Ujësjetllës Kanalizime Mat.....	6970
Vendim i Entit Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 23, datë 7.6.2017	Për një ndryshim në vendimin nr. 7, datë 3.2.2017, “Për licencimin e sh.a. Ujësjetllës Poliçan”.....	6971
Vendim i Entit Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 24, datë 7.6.2017	Për një ndryshim në vendimin nr. 49, datë 2.12.2016, “Licencimin për herë të parë të sh.a. Ujësjetllës Kanalizime Belsh”.....	6971

Vendim i Entit Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 25, datë 7.6.2017	Për licencimin e sh.a. Ujësjellës Kanalizime Skrapar.....	6971
	Vendim ( <i>i shkurtuar</i> ) për shpalljen të vdekur të shtetasit Ludovik Luigj Gruda.....	6971

**VENDIM****Nr. 485, datë 13.7.2017****PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI  
ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E  
ZHVILLIMIT URBAN TEK OPERATORI I  
SHPËRNDARJES SË ENERGJISË  
ELEKTRIKE, SHA, TË NJË PJESE TË  
PRONËS ME NUMËR PASURIE 1/63,  
NDODHUR NË ZONËN KADASTRALE  
NR. 8150, RRUGA “ABDI TOPTANI”,  
TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Zhvillimit Urban tek Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, sh.a., të një

pjesë të pronës me numër pasurie 1/63, tokë truall, me sipërfaqe 49 (dyzet e nëntë) m<sup>2</sup>, ndodhur në zonën kadastrale nr. 8150, rruga “Abdi Toptani”, Tiranë, për t’u përdorur nga OSHEE-ja për vendosjen e 2 (dy) kabinave elektrike, sipas planrilevimit dhe planimetrisë që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, sh.a., i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë atë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

3. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, sh.a., dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.


**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**







PARASHIKIMI I KABINES SE SPOSTUAR MINISTRIA E RENDIT





## UDHËZIM

Nr. 3743, datë 10.7.2017

**MBI MODELET DHE STANDARDET E BILETAVE TË TRANSPORTIT RRUGOR TË UDHËTARËVE**

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 21/2 të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, pikës 4 të kreut I dhe pikës 3 të kreut III, të vendimit nr. 85, datë 8.2.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave për prodhimin, shpërndarjen dhe pajisjen e udhëtarëve me bileta transporti rrugor”, ministri i Transportit dhe Infrastrukturës

## UDHËZON:

## 1. Qëllimi

Ky udhëzim ka për qëllim përmirësimin e ofrimit të shërbimeve të transportit publik dhe lehtësimit të procedurave për qytetarët, transparencën e përdorimit të këtyre shërbimeve, identifikimin e grupeve që përfitojnë lehtësira financiare në marrjen e shërbimeve publike në përputhje me kuadrin ligjor dhe shmangies së evazionit fiskal.

## 2. Fusha e zbatimit

Fusha e zbatimit të këtij udhëzimi është përcaktimi i modeleve dhe standardeve të biletave (me çmim të parashtypur dhe elektronike), si dhe përdorimi i tyre në transportin rrugor të udhëtarëve (qytetës, rrethqytetës, ndërqytetës, ndërkombëtar).

## 3. Përkufizime

a. “Transporti publik i udhëtarëve” është shërbimi i transportit të udhëtarëve të interesit ekonomik të përgjithshëm, ofruar publikut pa diskriminim dhe në mënyrë të vazhdueshme.

b. “Ministria” është ministria përgjegjëse për transportin.

c. “Biletë me çmim të parashtypur” është biletë për një udhëtim në shërbimin e transportit rrugor qytetës, rrethqytetës, ndërqytetës dhe ndërkombëtar, në format letër e prodhuar nga Shtypshkronja e Letrave me Vlerë, e cila shërben si dokument tatimor në përputhje me legjislacionin fiskal në fuqi.

ç. “Kartë Smart/financiare bankare” është pajisje në përmasat dhe kushtet teknike të kartave të kreditit, që kanë brenda një procesor, memorie RAM dhe ROM dhe kanë të integruar një *microchip* dhe antenë

NFC. Përdoren për shërbimin e udhëtimit në transport publik, në rastin e sistemit të biletimit elektronik.

d. “Kartat standarde Smart pa kontakt” janë karta që punojnë në frekuenca të caktuara. Të dhënat brenda kartës ruhen me një shifër (password/fjalëkalimi) dhe lexohet nga një largësi prej 5 centimetrash. Këto karta janë bileta që mund të kodohen dhe po ashtu lexohen me pajisje përkatëse, të përcaktuara për certifikimin e transaksionit ose kontrollin.

Kartat standarde Smart pa kontakt janë dy llojesh:

d.1 “Kartat standarde jo të personalizuar” janë karta sipër tyre nuk ka as fotografi, as emër apo ndonjë të dhënë tjetër personale dhe mund të përdoren nga çdokush që përdor sistemin e transportit publik.

d.2 “Kartat standarde të personalizuar” janë karta të cilat kanë brenda *chip*-it dhe sipër kartës, në mënyrë të dukshme, janë futur të dhënat personale të mbajtësit.

e. “Biletat elektronike me shirit magnetik” janë bileta prej letre, të cilat kanë sipër tyre, në sipërfaqe, një shirit magnetik, ku mund të kodohen. Këto bileta mund të kodohen dhe po ashtu lexohen me pajisje përkatëse të përcaktuara për certifikimin e transaksionit ose kontrollin.

ë. “Biletat elektronike pa kontakt” janë bileta elektronike që përdoren në kartat Smart pa kontakt dhe përdorin të njëjtat *chip*-e. Këto bileta mund të kodohen dhe po ashtu lexohen me pajisje përkatëse të përcaktuara për certifikimin ose kontrollin e transaksionit.

f. “Karta Smart” është një kartë plastike me *chip* të integruar, e cila mund të jetë kartë financiare e emetuar nga bankat ose kartë Smart jofinanciare e emetuar nga institucione të ndryshme. Kartat Smart funksionojnë si një mikrokompjuter dhe bëhen të lexueshme sa herë që në to kalon rrymë elektrike ose radiovalë, kur karta lexohet në distancë (pa e vënë në kontakt me pajisjen lexuese).

g. “Biletë elektronike me kartë Smart” është biletë që ruhet në formë elektronike në *chip*-in e kartave Smart jofinanciare. Këto bileta mund të kenë forma të ndryshme, si: biletë me një kalim, biletë me disa kalime ose bileta mujore, vjetore.

h. “Biletë elektronike me kartë Smart financiare” është biletë që ruhet në formë elektronike në *chip*-in e kartave Smart financiare ose karta financiare





përdoret si instrument për pagesën elektronike të biletës elektronike.

i. “Biletë elektronike e emetuar në çast”, e cila emetohet në bordin e autobusit, në makinat automatike të shitjeve, në pikat e shitjes së biletave të pajisura me aparatet përkatëse, në agjencitë e transportit rrethqytetës, ndërqytetës dhe ndërkombëtar të udhëtarëve dhe blerjet *online* në faqen elektronike (*web-in*) të shoqërive të transportit ndërkombëtar të udhëtarëve, nga një aplikacion *mobile* etj. Format i fizik (përmasat, konfigurimi, lloji i letres etj.) mund të ndryshojë në varësi të teknologjisë së përdorur. Materiali i përdorur për biletat e transportit ndërqytetës ndërkombëtar të udhëtarëve është letër termike ose jo, ose çdo lloj letre tjetër e përshtatshme për këtë aktivitet.

j. “Memorie RAM” është memorie e përkohshme në chip, e cila mund të rishkruhet dhe informacioni në të humbet, nëse në kartë nuk kalon më rrymë ose radiovalë.

k) “Memorie ROM” është memorie e përhershme në chip, e cila mund të rishkruhet dhe informacioni në të ruhet, nëse në kartë nuk kalon më rrymë ose radiovalë.

l. “Antenë NFC” është qarku i integruar në formë antene (*near field communication*), i vendosur në brendësi të plastikës së kartës *Smart*, i cili komunikon me *chip*-in e kartës *Smart* dhe nëpërmjet radiovalëve të mara nga pajisjet lexuese të kartave vë në funksion *chip*-in e kartës.

m. “Shirit magnetik” vendoset në pjesën plastike të kartës dhe shërben për të ruajtur informacion duke përdorur magnetizimin e shiritit.

n. “Algoritme të sigurta” janë algoritmet të cilat sigurojnë ruajtjen ose shkëmbimin e informacionit ndërmjet sistemeve në mënyrë të sigurt.

o. “Biletë elektronike/Karta *Smart* me funksion pa kontakt” janë biletat elektronike, të cilat janë të pajisura me antenë NFC.

p. “Format i biletës elektronike” nënkupton sasinë e informacionit, i cili është i nevojshëm dhe i domosdoshëm në përmbajtje të biletës.

q. “Frekuencat e kartës *Smart*” janë frekuencat në të cilat komunikon karta *Smart* pa kontakt.

r. “Sistemi i shifimit 3DES-Algorithm”, i cili garanton sigurinë e të dhënave gjatë ruajtjes apo shkëmbimit.

s. “Programim SAM i kartës *Smart*” është procesi i hedhjes së të dhënave në modulën e sigurt të kartave *chip*.

t. “Sistem Anti-Collision” është sistemi që ruan interferencat e radiovalëve.

u. “Mekanizëm i sigurisë automatike” është elementi i sigurisë i vendosur nga terminali dhe karta gjatë shkëmbimit të informacionit në distancë, me qëllim kryerjen e veprimit/transaksionit.

v. “Standardi ISO 14443” është standardi ISO për protokollin e komunikimit pa kontakt, ndërmjet kartës dhe terminalit të të dhënave/pajisjes lexuese.

x. “Standardi ISO 14443-4” është standardi ISO për protokollin e komunikimit pa kontakt, duke i referuar protokollin e transmetimit të të dhënave.

y. “Standardi EMV Contactless, për karta bankare për pagesat në distancë” është standardi i vendosur nga skemat ndërkombëtare të Europay MasterCard VISA për kartat me *chip* të përdorura, si instrumentet financiare, që mundëson vërtetësinë e transaksioneve me *chip* me kontakt apo në distancë.

z. “Pajisje certifikuese” është pajisja lexuese që kryen verifikimin dhe certifikimin e kartës *Smart* gjatë procesit të leximit me kontakt apo në distancë.

#### 4. BILETAT NË FORMAT LETËR ME ÇMIM TË PARASHYTPUR

Bileta tatimore me çmim të parashytpur për një udhëtim në transportin qytetës/rrethqytetës /ndërqytetës dhe transportin ndërkombëtar rrugor përmban në krye të saj të shënuar: Republika e Shqipërisë; Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Në mes shënohet lloji i biletës (qytetës/rrethqytetës/ndërqytetës dhe/ose transporti ndërkombëtar rrugor). Më poshtë shënohet çmimi (tarifa) e udhëtimit. Në fund, në cepin e djathtë, shënohet “Kodi i prodhimit” dhe “nr. serial”. Në krahun e majtë vertikalisht shënohen për efekt kontrolli përkatësisht “nr. serial” dhe “Kodi i prodhimit”.

Në biletat e transportit rrethqytetës dhe ndërqytetës shënohet edhe tarifa përkatëse.

Tarifat e biletave të transportit rrethqytetës të udhëtarëve miratohen me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Për rrjetin e linjave rrethqytetëse, sipas shkronjës “ç”, të nenit 15, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, tarifat përcaktohen me marrëveshje ndërmjet bashkive.

Çmimet e biletave të linjave ndërkombëtare të transportit me autobus dhe të bagazheve miratohen nga ministria përgjegjëse për transportin në bashkëpunim me organin kompetent të shtetit





tjetër, në çastin e lidhjes së marrëveshjes ose të dhënies së licencës/autorizimit për operim në linjë ndërkombëtare.

Bileta tatimore për disa udhëtime, bileta e pajtimit/aboneja për transportin qytetës përmban në krye të saj të shënuar: Republika e Shqipërisë, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, llojin e abonesë (abone e përgjithshme ose abone linje “emërtesa”). Në mes të biletës shënohet muaji me shkronja dhe viti me numra natyrorë dhe lloji i autobusit (qytetës). Në krahun e djathtë vertikalisht vendoset shiriti i sigurisë dhe pas tij shënohet bashkia ku është e vlefshme bileta, (shembull: Bashkia Tiranë).

Në pjesën e poshtme shënohet numri i biletës. Në krahun e majtë lart shënohet “seria”. Në krahun e majtë në mes shënohet, me numër natyror, numri i muajit dhe poshtë saj shënohet çmimi i biletës me numra natyrorë dhe monedha (në lekë). Në krahun e majtë në cep të biletës shënohet “Shtypur: Shtypshkronja e Letrave me Vlerë, Tiranë”.

Bashkitë/ministria, nëse për qëllime të identifikimit të linjave të tyre të transportit, përcaktojnë ngjyrën/at e biletave, të ndryshme nga ngjyra e unifikuar në përdorim, atëherë njoftojnë zyrtarisht Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, për ndryshimin e porosisë të Shtypshkronja e Letrave me Vlerë.

Shtypja e biletave në format letër me çmim të parashitë realizohet nga Shtypshkronja e Letrave me Vlerë, në përputhje me kriteret e përcaktuara në VKM-në nr. 1497, datë 19.11.2008, “Për shtypjen e letrave me vlerë”, të ndryshuar.

## 5. BILETAT NË FORMATIN ELEKTRONIK

Në përdorimin e biletave në formatin elektronik, të mbahen parasysh detyrimet e parashikuara në VKM-në nr. 85/2017 “Për përcaktimin e rregullave për prodhimin, shpërndarjen dhe pajisjen e udhëtarëve me bileta të transportit rrugor” dhe në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi.

5.1 Modeli biletës elektronike me kartë *Smart*/kartë financiare bankare

Kartat *Smart*/financiare bankare janë pajisje në përmasat dhe kushtet teknike të kartave të kreditit që kanë brenda një procesor, memorie RAM dhe ROM dhe kanë të integruar një *microchip* dhe antenë NFC. Është një kartë plastike, e cila përdor

teknologji të ndryshme për t’u lidhur me lexuesin përkatës, si shirit magnetik, barkod ose frekuencat e radiove pa kontakt dhe me anë të aplikacioneve të ndryshme përpunon të dhënat përkatëse. Për shkak të veçorive të aksesit të kontrollueshëm, të dhënat personale dhe tregtare mund të shikohen vetëm nga personat e autorizuar.

Kartat *Smart*, përveç pjesës së sistemit të biletimit elektronik në fushën e transportit, mund të integrohen dhe përdoren në aplikacionet që përfshijnë aktivitete dhe sisteme të ndryshme, siç janë pagesat financiare bankare, duke garantuar ruajtjen e të dhënave personale, si në kontrollin e hyrjeve, transaksioneve financiare në mënyrë elektronike, si dhe verifikimin e të dhënave për të drejtën e përfitimit të shërbimit.

Kartat duhet të garantojnë kapacitet të lartë në procesin e veprimeve, nëpërmjet përdorimit të algoritmeve të sigurta.

5.2 Bileta elektronike/kartat standarde *Smart* që funksionojnë pa kontakt me pajisjet certifikuese dhe kontrolluese

Punojnë në frekuencat të caktuara (si frekuenca 13,56 Mhz për aparatet që zbatojnë standardet ISO/IEC 18092, ISO/IEC 14443 dhe ISO/IEC 15693). Të dhënat brenda kartës ruhen me një shifër (password/fjalëkalimi), që lexohet nga një largësi prej rreth 5 centimetrash. Të dhënat brenda kartës mund të lexohen ose ndryshohen vetëm nëpërmjet futjes së shifrës së saktë.

Specifikimet teknike që duhet të plotësojnë kartat *Smart*, që funksionojnë pa kontakt me pajisjet certifikuese dhe kontrolluese:

- a. Standardi ISO/IEC 7810 ID-1, për përmasat e kartës;
- b. Sistemet e shifrimit 3DES dhe AES, duke garantuar një siguri të nivelit më të lartë;
- c. Programimin SAM për të arritur një siguri të pavarur;
- d. Sistemin Anti-Collision, që të mund të kryhen veprime në më shumë se me 1 kartë, me vlerë minimale të memories së kartës 1 kb etj.;
- e. Sistemi i memories duhet të jetë shumë elastik;
- f. Të lejojë transferimin e të dhënave në shpejtësinë 848 kbit/s;
- g. Standardi ISO/IEC 14443-4;
- h. Mekanizëm të sigurisë automatike gjatë kryerjes së veprimeve.



5.3 Biletat elektronike *Smart*/karta financiare bankare, që funksionojnë pa kontakt me pajisjet certifikuese dhe kontrolluese.

Përdoren të njëjtat *chip*-e që përdoren në kartat *Smart* pa kontakt. Këto bileta mund të kodohen dhe po ashtu lexohen me pajisje përkatëse të përcaktuara për certifikimin e transaksionit ose kontrollin. Këto modele biletash në sistemin e transportit mund të përdoren për aq kohë sa kanë vlefshmërinë e përdorimit të tyre nga lëshuesi dhe sipas vlerës financiare të kredituar mbështetur në çmimin përkatës të udhëtimit.

Specifikimet teknike që duhet të plotësojnë biletat elektronike *Smart*, që funksionojnë pa kontakt me pajisjet certifikuese dhe kontrolluese:

a. janë në standardet ISO/IEC 14443 etj.;

b. punojnë në frekuencat të caktuara (që për standardin ISO/IEC 14443 është frekuenca 13,56 Mhz);

c. mbështesin shpejtësinë e transferimit të të dhënave 106 kbit/s;

d. bazuar në standardin bankar EMV për pagesat me kartë në distancë.

Kartat standarde *Smart*, që funksionojnë pa kontakt me pajisjet certifikuese dhe kontrolluese, ndahen në dy kategori:

5.3.1 “Kartat standarde jo të personalizuar” janë karta të cilat sipër tyre nuk kanë as fotografi, as emër apo ndonjë të dhënë tjetër personale. Mund të përdoret nga çdokush që përdor sistemin e transportit publik. Kartat lejojnë që në çdo moment që vlera financiare, e cila lidhet me numrin e udhëtimeve në shërbimin e transportit, ka përfunduar, të mund të rimbushen. Në këtë mënyrë lejohet përdorimi si për biletë dhe ose udhëtim, sipas numrit të udhëtimeve që do të mbushet, ashtu dhe për përdorimin kartelet pajtimi (abone)/mujore të përgjithshme ose linje, apo të çdo formë biletimi ose kartelet pajtimi (abone) që ministria ose njësitë e qeverisjes vendore kanë të aprovuar.

5.3.2 “Kartat standarde të personalizuar” janë karta të cilat kanë brenda *chip*-it dhe sipër kartës, në mënyrë të dukshme, të dhënat personale të mbajtësit. Kjo kartë e personalizuar duhet të përdoret referuar legjislacionit në fuqi, ku aktualisht këtë të drejtë e përfitojnë:

5.3.2.1 *Invalidët e punës*: Ligji nr. 7889, datë 14.12.1994, “Për statusin e invalidëve të punës”, i ndryshuar;

5.3.2.2 *Të verbrit*: Ligji nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, i ndryshuar;

5.3.2.3 *Jetimët*: Ligji nr. 8153, datë 31.10.1996, “Për statusin e jetimit”, i ndryshuar;

5.3.2.4 *Invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë*: Ligji nr. 8626, datë 22.6.2000, “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, i ndryshuar;

5.3.2.5 *Studentët*: Ligji nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

5.3.2.6 *Çdo subjekt ose kategori që mund të përfitojë në vijim, mbështetur në legjislacionin në fuqi.*

5.3.2.7 Kartat lejojnë që në çdo moment të kontrollohet numri i udhëtimeve i përfituesve të mësipërm nëse kjo është falas ose me uljet përkatëse financiare, si dhe në rastet e çdo forme të aplikimit që kërkon identifikim, mbështetur në legjislacionin në fuqi, për kompensimin e vlerave financiare përkatëse, të cilat lidhen me numrin e udhëtimeve ose aboneve përkatëse në shërbimin e transportit.

5.3.2.8 E drejta e përdorimit për këto karta duhet të rinovohet çdo gjashtë muaj ose çdo një vit, sipas kërkesave ose kushteve përkatëse që mundësojnë identifikimin për të drejtën e përfitimit.

5.4 Modeli i biletës elektronike jo nëpërmjet kartës

Janë modele biletash si mjete pagese pa ose me vazhdimësi të kufizuar, që përdoren në sistemin e transportit. Qëllimi kryesor është që të jenë një model biletimi elektronik, si mjet pagese krahas kartave *Smart*.

5.4.1 Biletat elektronike me shirit magnetik që funksionojnë me kontakt me pajisjet certifikuese dhe kontrolluese

Këto janë bileta prej letre, të cilat kanë sipër tyre, në sipërfaqe, një shirit magnetik, ku mund të kodohen. Këto bileta mund të kodohen dhe po ashtu lexohen me pajisje përkatëse të përcaktuara për certifikimin e transaksionit ose kontrollin. Këto modele biletash në sistemin e transportit mund të përdoren vetëm një herë për udhëtar/udhëtim ose në maksimumin e përdorimit 10 herë për udhëtar/udhëtim, sipas formës së kredituar mbështetur në çmimin/tarifën e udhëtimit.

Specifikimet teknike që duhet të plotësojnë biletat elektronike me shirit magnetik, që funksionojnë me kontakt me pajisjet certifikuese dhe kontrolluese:



- a. standardet ISO/IEC 7811-6:2001;
- b. Hi-Co;
- c. rezolucion të të dhënave 86 bpi;
- d. Track II;
- e. pjesa e prapme e tyre është termale.

#### 5.5 Modelimi i biletimit elektronik

Për modelimin e kartave dhe biletave, ministria ose njësitë e qeverisjes vendore, sipas kërkesave teknologjike të sistemeve që do të aplikojnë, konsiderojnë sa më poshtë:

5.5.1 Standardet e modelimit të biletave me shirit magnetik:

- a. përmasat;
- b. ndarja e ngjyrave sipas llojit të biletës (nëse ka të tillë);
- c. ndarja e pamjes sipas llojit;
- d. paraqitja e llojit të biletës në pjesën e përparme;
- e. në pjesën e prapme shiriti magnetik;
- f. vendosja e shkrimeve të detyrueshme në pjesën e përparme dhe të prapme;
- g. vendosja e logos së bashkisë/ministrisë /kompanisë në pjesën e përparme/prapme.

5.5.2 Standardet e modelimit të biletave *Smart*:

- a. përmasat;
- b. ndarja e ngjyrave sipas llojit të biletës (nëse ka të tillë);
- c. ndarja e pamjes sipas llojit;
- d. paraqitja e llojit të biletës në pjesën e përparme;
- e. vendosja e shkrimeve të detyrueshme në pjesën e përparme dhe të prapme;
- f. vendosja e logos së bashkisë/kompanisë në pjesën e përparme/prapme.

5.5.3 Standardet e modelimit të kartave *Smart*:

- a. Përmasat.
- b. Ndarja e ngjyrave sipas llojit të biletës (nëse ka të tillë).
- c. Ndarja e pamjes sipas llojit të kartës.
- d. Shenja “pa kontakt” të gjendet në pjesën e përparme të kartës.
- e. Paraqitja e llojit të kartës në pjesën e përparme/prapme.
- f. Vendosja e shkrimeve të detyrueshme në pjesën e përparme dhe të prapme.
- g. Vendosja e logos së bashkisë/ministrisë /kompanisë në pjesën e përparme/prapme.
- h. Në pjesën e prapme duhet të jenë të dhënat informuese, si: nr. tel. cel., *email* etj., për komunikim.

i. Në rastet e kartave të personalizuara vendosen të dhënat përkatëse për identifikimin, si dhe fotografia.

j. Prodhimi i kartave të personalizuara bëhet duke konsideruar ligjin nr. 988, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, me deklarinimin e përdoruesit për përdorimin e të dhënave personale për këtë qëllim.

#### 5.6 Sistemet e biletimit elektronik (SBE)

5.6.1 Institucionet e përmendura në VKM-në nr. 85, datë 8.2.2017, “Për përcaktimin e rregullave për prodhimin, shpërndarjen dhe pajisjen e udhëtarëve me bileta të transportit rrugor”, sipas shërbimeve të transportit që kanë në kompetencë, janë përgjegjëse për hartimin e kushteve teknike në formën që gjykohej e përshtatshme për ngritjen e sistemit të biletimit elektronik, lidhur me pajisjet emetuese, lexuese, certifikuese dhe kontrolluese të biletave elektronike, si dhe gjithë teknologjisë mbështetëse, pajisjeve dhe aparaturave, programeve, sistemit qendror të ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave, si dhe komunikimit të sigurt.

5.6.2 Sistemet e biletimit elektronik duhet të kënaqin të paktën kërkesat e mëposhtme:

a) Lejimin ose të jenë të predispozuar për përdorimin e biletave të udhëtimit të llojeve të ndryshme, në përputhje me kërkesat dhe standardet e përcaktuara në këtë udhëzim, duke garantuar ndërveprimin e proceseve të emetimit, rinovimit, rimbushjen, vlefshmërinë dhe kontrollin e biletave.

b) Lejimin, nëpërmjet suportit përkatës, rinovimit, rimbushjen, vlefshmërinë dhe kontrollin e biletave të transportit qytetës, rrethqytetës, ndërqytetës, ndërkombëtar edhe për shërbime të integruara, të përdorshme për shërbime të ndryshme lëvizshmërie, duke përfshirë ato automobilistike, hekurudhore, shërbimeve të lëvizshmërisë kolektive etj.;

c) Parashikimin, duke përdorur zgjidhje teknike dhe organizative, në përputhje me nisjen e çdo udhëtimit ose transferimin, detyrimin e vlefshmërisë së biletës përkatëse, edhe në mënyrë automatike, nëpërmjet aparaturave tokësore dhe të vendosura në bordin e autobusit.

d) Lejimin, nëpërmjet pajisjeve portabël të përshtatura/përdorshme për komunikimin të rimbushjes së ardhshme të biletave, nëpërmjet



transmetimit të të dhënave, si dhe vlefshmërinë dhe kontrollin e tyre.

e) Lejimin e identifikimit të njëjtë të biletave të ndryshme, me anë të pajisjeve portabël ose me sistemet *back-office* të ndërmarrjes/shoqërisë së transportit.

6. Modeli i biletave në transportin qytetës, rrethqytetës dhe ndërqytetës i udhëtarëve, në formatin letër dhe elektronik, është sipas lidhjes 1 të këtij udhëzimi.

7. Njësitë e qeverisjes vendore përcaktojnë vetë nëse, në shërbimin e transportit publik brenda juridiksionit të tyre, do të përdoret formati i biletave me çmim të parashtypur, ose në formatin e biletimit elektronik në përputhje me dispozitat e këtij udhëzimi.

8. Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TRANSPORTIT  
DHE INFRASTRUKTURËS  
Sokol Dervishaj

Nr.Serial 000000	KONTROLLI	Kodi i prodhimit 00/00	REPUBLIKA E SHQIPËRISË			ETIKETA E BAGAZHIT	MINISTRIA:
			MINISTRIA E FINANCAVE/ DREJTORIA E PERGJITHSHME E TATIMEVE				
			<b>BILETE TRANSPORT NDËRQYTETAS</b>				
			Vendi nisjes _____	Emri i operatorit : _____			
			Vendi mbërritjes _____	Nipt: _____			
			Nr. vendit _____	Tel: _____	Kodi i prodhimit 00/00		
			Data _____, Ora _____	Targa _____	Nr.Serial 000000		
			Gjatësia e udhëtimit _____ Km	Çmimi total _____	Leke		
Shtypur: Shtypshkronja e Letrave me Vlere, Tirane							
Nr.Serial 000000	KONTROLLI	Kodi i prodhimit 00/00	REPUBLIKA E SHQIPËRISË			ETIKETA E BAGAZHIT	BASHKIA:
			MINISTRIA E FINANCAVE/ DREJTORIA E PERGJITHSHME E TATIMEVE				
			<b>BILETE TRANSPORT RRETHQYTETAS</b>				
			Vendi nisjes _____	Emri i operatorit : _____			
			Vendi mbërritjes _____	Nipt: _____			
			Nr. vendit _____	Tel: _____	Kodi i prodhimit 00/00		
			Data _____, Ora _____	Targa _____	Nr.Serial 000000		
			Gjatësia e udhëtimit _____ Km	Çmimi total _____	Leke		
Shtypur: Shtypshkronja e Letrave me Vlere, Tirane							



<b>Nr.Serial 000000</b>	<b>KONTROLLI</b>	<b>Kodi i prodhimit 00/00</b>	REPubLIKA E SHQIPËRISË						<b>BASHKIA:</b>
			MINISTRIA E FINANCAVE/ DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE						
			BILETE TRANSPORT QYTETAS						
			Emri i operatorit : _____						
			Nipt: _____						
			Tel: _____			Kodi i prodhimit 00/00			
			Çmimi _____ Leke			Nr.Serial 000000			
Shtypur: Shtypshkronja e Letrave me Vlere, Tirane									

<b>Nr.Serial 000000</b>	<b>KONTROLLI</b>	<b>Kodi i prodhimit 00/00</b>	REPubLIKA E SHQIPËRISË						<b>BASHKIA:</b>
			MINISTRIA E FINANCAVE/ DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE						
			BILETE PAJTIMI MUJOR/ ABONE TRANSPORT QYTETAS						
			Emertitimi: E pergjithshme/ Linje						
			Emri i operatorit : _____						
			Nipt: _____						
			Tel: _____			Kodi i prodhimit 00/00			
Çmimi _____ Leke			Nr.Serial 000000						
Shtypur: Shtypshkronja e Letrave me Vlere, Tirane									

REPubLIKA E SHQIPËRISË										Vula e zyrës nisëse (Seal of office)	
MINISTRIA E FINANCAVE/ DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE											
BILETË TRANSPORT NËRKOMBËTAR RRUGOR /INTERNATIONAL ROAD TRANSPORT TICKET											
Emri Name _____					Emri i operatorit Operator's name _____					Shitur në Sold on Data _____ Date _____ Muaji _____ Month _____ Viti _____ Year _____	
Mbiemri Surname _____					Tel: _____						
Numri i pasaportes Pass. Number _____					Gjatësia e udhëtimit (km) Jorney's length (km) _____						
Kodi i linjes Line code	Nga/From		Data Date	Muaji Month	Viti Year	Ora Time	Vendi Seat	Ulje Çmimi Discount	<b>ÇMIMI TOTAL</b> <b>TOTAL AMOUNT</b>		
	Në/To										
	Nga/From							Arsyeja Reason			
	Në/To										
Shënim/Note :										Kodi i prodhimit N/00	
Shtypur: Shtypshkronja e Letrave me Vlerë, Tiranë										Nr.Serial 000000	
<b>ETIKETA E BAGAZHILUGGAGE LABEL</b>											
<b>Nr.Serial 000000</b>											

**URDHËR****Nr. 156, datë 14.7.2017****PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe neneve 22, 28 dhe 29 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”

**URDHËROJ:**

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, z. Elird Qëndro, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse për prokurimet e fondeve publike, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe udhëzimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik të dala në bazë dhe për zbatim të procedurave përkatëse.

2. Kompetencat e deleguara të titullarit të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë do të ushtrohen për periudhën, nga hyrja në fuqi e këtij urdhri deri në datën 31.12.2017.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimeve Mbështetëse z. Elird Qëndro.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**TITULLARI I AUTORITETIT  
KONTRAKTOR  
Xhulieta Kërtusha**

**VENDIM****Nr. 19, datë 11.5.2017****PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS  
KANALIZIME LIBRAZHD**

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, Komisioni Kombëtar Rregullator

**VENDOSI:**

1. Licencimin e operatorit sh.a. Ujësjiellës Kanalizime Librazhd me:

drejtues ligjor Agron Gega,  
drejtues teknik Luan Mema.

2. Operatori sh.a Ujësjiellës Kanalizime Librazhd autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategorinë:

Kategoria A, për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

Kategoria C, për largimin e ujërave të ndotura.

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është: bashkitë Librazhd dhe Përrenjas.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4 (katër) - vjeçare.

**KRYETARI  
Ndrçim Shani**

**VENDIM****Nr. 22, datë 7.6.2017****PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS  
KANALIZIME MAT**

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, Komisioni Kombëtar Rregullator

**VENDOSI:**

1. Licencimin e operatorit sh.a. Ujësjiellës Kanalizime Mat me:

drejtues ligjor Arjan Lika  
drejtues teknik Nazmi Mallunxa

2. Operatori sh.a. Ujësjiellës Kanalizime Mat autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategorinë:

Kategoria A, për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

Kategoria C, për largimin e ujërave të ndotura.

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është: bashkia Mat.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4 (katër) -vjeçare.

**KRYETARI  
Ndrçim Shani**



**VENDIM**  
**Nr. 23, datë 7.6.2017**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN**  
**NR. 7, DATË 3.2.2017, “PËR**  
**LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS**  
**POLIÇAN”**

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” Komisioni Kombëtar Rregullator

**VENDOSI:**

Në vendimin nr. 7, datë 3.2.2017, “Për licencimin e sh.a. Ujësjetllës Poliçan” bëhen këto ndryshime:

1. Zona e shërbimit të këtij operatori është: bashkia Poliçan.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**Ndriçim Shani**

**VENDIM**  
**Nr. 24, datë 7.6.2017**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN**  
**NR. 49, DATË 2.12.2016, “LICENCIMIN**  
**PËR HERË TË PARË TË SHA**  
**UJËSJELLËS KANALIZIME BELSH”**

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” Komisioni Kombëtar Rregullator

**VENDOSI:**

Në vendimin nr. 49, datë 2.12.2016, “Licencimin për herë të parë të sh.a. Ujësjetllës Kanalizime Belsh” bëhen këto ndryshime:

1. Drejtues ligjor: Endri Pepa.  
 Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**Ndriçim Shani**

**VENDIM**  
**Nr. 25, datë 7.6.2017**

**PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS**  
**KANALIZIME SKRAPAR**

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, Komisioni Kombëtar Rregullator

**VENDOSI:**

1. Licencimin e operatorit sh.a. Ujësjetllës Kanalizime Skrapar me:

drejtues ligjor Fikret Telha;  
 drejtues teknik Fatjon Hysi.

2. Operatori sh.a. Ujësjetllës Kanalizime Skrapar autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategorinë:

Kategoria A, për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

Kategoria C, për largimin e ujërave të ndotura.

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është: bashkia Skrapar.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4 (katër) -vjeçare.

**KRYETARI**  
**Ndriçim Shani**

**VENDIM**  
*(i shkurtuar)*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 588 (1864), datë 3.5.2017, vendosi shpalljen e vdekjes së shtetasit Ludovik Luigj Gruda, i biri i Luigjit dhe i Prendës, i datëlindjes 13.3.1965, lindur në Shkodër dhe vdekur më 21.7.1986



	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2017

Adresa:  
Bulevardi “Gjergj Fishta”  
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”

Çmimi 112 lekë